

**Akti i Themelimit
të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
“Qendra Shqip” Shpk.**

Sot me 02.02.2022, bazuar ne ligjin nr.9901, dt 14.04.2008 ” Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” firmoset dhe hartohet ky akt themelimi i shoqërisë “Qendra Shqip” shpk, nga ortakët:

- 1-Shpresa Dorda , e bija e Mafmutit ,lindur më 13.06.1984, në Tiranë dhe banues në Tiranë, madhre dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me pasaportë me nr.personal I45613056E.
- 2- Fatos Dorda , i biri i Ramizit, lindur më 15.04.1975 në Tiranë, banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me pasaportë me nr.personal H50415066F

Të cilët, nëpërmjet nënshkrimit të këtij akti themelimi, vendosën të themelojnë, në cilësinë e ortakëve të shoqërisë, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe dispozitave të mëposhtme, me emërimin “ Qendra Shqip” Shpk.

**Neni 1.
Krijimi**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “ Qendra Shqip” shpk., është krijuar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 2.
Ortakët Themelues**

Emri dhe adresa e ortakut themelues është:

Emri i Ortakëve _____


Adresa e Ortakut

1. **Shpresa DORDA**
2. **Fatos DORDA**

Tiranë
Tiranë

**Neni 3.
Zyra Qëndrore**

3.1 Shoqëria e ka Zyrën Qëndrore të saj në Tiranë në adresën: Rruga “Balla”, sht.12, Njësia Administrative nr.1, Tiranë



Neni 4.

Objekti

4.1 Objekti i shoqërisë “Qendra Shqip” shpk do të jetë:
Trajnime me tematikë “Hartimi i shkresave zyrtare”, “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe” dhe “Redaktor”

4.2 Kohëzgjatja e aktivitetit të kësaj shoqërie do të jetë pa afat.

Neni 5 -Kontributet dhe pjeset e kapitalit

5.1 “Qendra Shqip” shpk do të ketë një kapital fillestar minimal prej 10.000(dhjetëmijë) lekë ose kundërvlera e tij në dollarë amerikanë (US\$) ose në monedhën europiane (Euro). Kapitali prej 10.000(dhjetëmijë) lekë është i ndarë në 2(dy) kuota. Themeluesit marrin në pronësi kuotat e tyre në kapital themeltar në përputhje me kontributin e tyre.

Kontributi i ortakëve themelues në kapitalin themeltar është si më poshtë:

1.Shpresa Dorda.1 Kuotë, me vlerë 7000 Lekë, zotëron70%(shtatëdhjetë).

2.Fatos Dorda 1 Kuotë, me vlerë 3000Lekë, zotëron30%(tridhjetë).

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet në cdo kohë sipas vendimit që mund të marrin ortakët e saj.

Neni 6

Prfaqësuesi Ligjor

6.1 Shoqëria do të administrohet nga një Përfaqësues Ligjor. Nëpërmjet këtij Akti Themelimi, emëohet në cilësinë e Përfaqësuesit Ligjor Administratorja Znj. **Shpresa DORDA** shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë, më 13.06.1984, mbajtës i pasaportës me numër I45613056E. Përfaqësuesi ligjor do të qndrojë në detyrë për një afat prej 5(pesë) vitesh, me të drejtë ripërtritje të kësaj detyre, me Vendim të Ortakëve.

Neni 7

Të drejtat e Administratorit

7.1 Administratori i shoqërisë lartpërmendur, është i veshur me të gjitha atributet për drejtimin e zakonshëm dhe te jashtëzakonshëm të shoqërisë, pa asnjë përjashtim dhe kufizim. Ai ka mundësi të përpilojë të gjitha aktet që konsiderohen të nevojshme për arritjen e qëlimeve të shoqërisë. Ai ka të drejtë të blejë dhe të këmbejë pasuri, të lidhet me shoqëri të tjera. Ai kryen cdo lloj veprimi pranë të gjitha zyrave shtetërore dhe private që kanë të bëjnë me garancitë dhe veprimet hipotekore veprimet. Të gjitha këtotribute do të shoqërohen rast pas rasti me autorizim të vecantë nga ana e ortakëve dhe vetëm në këtë mënyrë veprimet e administratorit marrin fuqi ligjore.



Neni 8
Përgjegjësia Personale

8.1 Prona private e ortakut jashtë kufirit të kuotave që ai zotron në kapitalin e shoqërisë, drejtuesit, administratorët, punëmarrësit, dhe/ose përfaqësuesit e shoqërisë, janë të përjashtuar nga detyrimet e çdo lloji që rëndojnë mbi shoqërinë.

Neni 9
Norma të Organizimit

9.1 Normat për organizimin, rregullat dhe drejtimi e administrimi i aktivitetit të shoqërisë “Qendra Shqip” shpk. dhe çështjeve të saj të brendshme, janë parashikuar në Statutin bashkëngjitur, i cili mund të modifikohet në çdo moment me vendim të Ortakëve.

Neni 10
Fillimi i Aktivitetit

10.1 Shoqëria “Qendra Shqip” shpk do të ketë një kapital fillestar prej 10.000 (dhjetëmijë) Lekë ose kundërvlera e tij në dollarë amerikane (US\$) ose në monedhën europiane (Euro).

ORTAKËT

Shpresa DORDA



Fatos DORDA

